

SCORP X ACMS

FUSHATA ZERO DISKRIMINIM

DISKRIMINIMI NDAJ BURRAVE

Çfarë është? Ku ndodh? Si ta luftojmë?



Përmbajtje

1. Kujt i drejtohet ky libërth?
2. Çfarë është diskriminimi?
3. Diskriminimi i burrave në familje.
4. Diskriminimi i burrave në vendet e punës.
5. Diskriminimi i burrave në gjykata dhe instanca të tjera shtetërore.
6. Pasojat e diskriminimit tek burrat.
7. Çfarë mund të bëjmë ne?



Kujt i drejtohet ky libërth?

1. Individëve djem që kanë rënë pre e një padrejtësie në shoqëri, institucione arsimore apo vend pune bazuar në stereotipin e gjinisë së tyre dhe jo në bazë të aftësive të tyre dhe përgatitjes së tyre profesionale.
2. Individëve, të cilët janë ngacmuar dhe sulmuar personalisht në mënyrë verbale, fizike apo seksuale.
3. Individëve, të cilëve iu është privuar e drejta e fjalës, konkurimit, bashkëpunimit në vendin e punës, në mënyrë të padrejtë.
4. Individëve, të cilët për shkak të veprimeve të kësaj natyre, janë ndjerë të poshtëruar, sulmuar dhe të pafuqishëm për të folur apo për t'u mbrojtur.
5. Individëve, të cilët janë kërcënuar me dhunë verbale ose fizike në rast të ankimit apo denoncimit të veprimeve të natyrës diskriminuese të përshkruara në këtë libërth.
6. Individëve, të cilët nuk janë në dijeni të institucioneve apo departamenteve ku mund të drejtohen në rastet kur dëshmojnë apo bien pre e një sjelljeje diskriminuese nga një person i dytë ose grup njerezish.
7. Individëve, të cilët janë të interesuar të mësojnë më shumë mbi këtë temë.

Çfarë është diskriminimi?



Diskriminimi është akti i nxjerrjes në pah të dallimeve të pajustificuara midis qenieve njerëzore bazuar në grupe, klasa ose kategori të tjera në të cilat mendohet se përkasin. [1]

Njerëzit mund të diskriminohen në bazë të racës, gjinisë, moshës, fesë ose orientimit seksual, si dhe kategorive të tjera. [2] Diskriminimi ndodh veçanërisht kur individët ose grupet trajtohen padrejtësisht në një mënyrë më të keqe sesa trajtohen njerëzit e tjerë, në bazë të anëtarësimit të tyre aktual ose të perceptuar në grupe ose kategori të caktuara shoqërore. [2] [3]

Ai përfshin kufizimin e anëtarëve të një grupi nga mundësitë ose privilegjet që janë në dispozicion të anëtarëve të një grupi tjetër. [4]

P.s.: Për të mos kontribuar në thellimin e mëtejshëm dhe nxitjen e veprimeve diskriminuese, termat "mashkull"/ "femër" janë zëvendësuar me "burra"/ "djem" dhe "gra"/ "vajza".

Diskriminimi i burrave në familje [5]

Shtëpia është vendi i parë ku fëmijët shoqërohen me norma, vlera dhe stereotipe gjinore. Që nga momenti i lindjes së foshnjave, gjinia e tyre e caktuar (mashkull ose femër) fillon menjëherë të formësojë se si duhet të trajtohen, cilat mundësi duhet të marrin ose si duhet të sillen sipas stereotipeve gjinore dominuese në shoqërinë e tyre. Ndonëse theksi vihet në diskriminimin e grave, edhe burrat janë po kaq të diskriminuar.

Burrat sjellin më shumë të ardhura në familje.

Rezultatet e dala nga “Barazia Ndërkombëtare për Burrat dhe Gratë”, tregojnë se një pjesë relativisht e lartë e burrave raportojnë se ata shpesh kanë turp të përballen me familjen e tyre, janë të stresuar ose të dëshpëruar si një rezultat i të ardhurave shumë të pakta, të qenit i papunë ose i papunësuar. Këto përfundime konfirmohen edhe nga një studim i udhëhequr në Indi, ku nga 1,552 burra të intervistuar në sondazhin e familjeve në dy qytete, 30 përqind thanë se kishin turp të përballeshin me familjen, prej turpit nga papunësia.



Burrat migrojnë më shumë.

Sipas modeleve klasike, janë baballarët ata që migrojnë, në pjesën më të madhë të rasteve edhe vetëm, duke dërguar të ardhura në familje. Ata kthehen në shtëpi pasi të kenë arritur qëllimet e tyre. Migrimi mund të ndikojë në rolet dhe praktikat e baballarëve në mënyra të shumta. Nga njëra anë baballarëve që migrojnë, shpesh u ofrohen kushte më të mira shoqërore dhe ekonomike për të kryer rolet e tyre atërore, mirëpo nga ana tjetër i distancon ata nga familja.

Përgjegjësia e shtuar e djemve fillon që në moshë të re.

Studime të shumta konfirmojnë se djemtë përballen me presionin shoqëror për t'iu përshtatur stereotipave gjinorë si "mbajtës të familjes", duke shkaktuar turp nëse nuk mundën të përmbushin prirje te tilla. Për shumicën e djemve në të gjithë botën, punësimi i qëndrueshëm është rruga për t'u njohur shoqërisht si burra të rritur, i cili në shumicën e pjesëve të botës shoqërohet me formimin e familjes. Sidoqoftë, shumë të rinj nuk janë në gjendje të fitojnë punësim te qëndrueshëm.

Si pasojë, rrugët e tyre drejt formimit të familjes shpesh bllokohen ose ndryshe pengohen. Një përqindje në rritje e djemve janë të papunë ose punojnë me pagë të ulët. Për shembull, në mesin e të rinjve 15–24 vjeç, normat e papunësisë janë 29 përqind në Sri Lanka, 30 përqind në Greqi, 33 përqind në Itali, 34–35 përqind në Xhamajka, Egjipt dhe Marok dhe 56 përqind në Afrikën e Jugut.



Diskriminimi i burrave në vendin e punës [6]

Punonjësit burra trajtohen më keq në industrinë e mbizotëruara nga gratë

Ndërsa burrat tradicionalisht kanë qenë fituesit e pagës në shumicën e familjeve dhe dihet që mbajnë një përqindje disproporcionale të pozitave ekzekutive, ka disa industri dhe punë ku gratë kanë mbajtur historikisht pushtetin. Për shembull, mësuesit, infermierët dhe ofruesit e kujdesit për fëmijët, ndonjëherë mund të përballen me diskriminim gjinor mashkullor për shkak të seksit ose gjinisë së tyre. Kjo mund të bëjë që ata të mos konsiderohen për punësim ose ngritje në detyrë ose të marrin vlerësime më të këqija të performancës, sepse nuk përputhen me stereotipet gjinore të lidhura me industrinë. Kur burrat trajtohen më keq sesa gratë që bëjnë të njëjtën punë, shpesh mund të jetë diskriminim gjinor mashkullor.



Burra ngacmojnë seksualisht burra të tjerë në punë

Në vitin 2020, u ngrit një proces gjyqësor kundër një agjencie turistike, bazuar në ngacmimet seksuale të të njëjtit seks. Presidenti i kompanisë u pretendua të rekrutonte të rinj për kompanitë e tij dhe më pas t'i ngacmonte seksualisht në forma si:

1. Ftesa e tyre në festa seksi
2. Duke u treguar atyre video dhe foto pornografike
3. Duke kërkuar që ata të ekspozojnë veten nëse duan të punësohen
4. Bazimi i mundësive të punësimit në akte seksuale
5. Angazhimi në veprime seksuale të padëshiruara, jo konsensuale

Punonjësit u ankuan për sjelljen e presidentit, por u detyruan ose të braktisin punën, ose u përballën me hakmarrje në vend që të merrnin ndonjë përgjigje domethënëse. Kur një epror mashkull kërkon sjellje seksuale të punonjësve të tij burra, është ngacmim i paligjshëm seksual, dhe ka të ngjarë që të jetë më shumë sulm seksual kriminal.



Stereotipi "i të qenit burrë"

Burrat gjithashtu përballen me diskriminim gjinor kur nuk përshtaten në stereotipet për gjininë e tyre. Për shembull, në *Wildhaber v St. Louis County, MO*, një oficer policie paditi për diskriminim gjinor mashkullor. Ai u anashkalua për ngritje në detyrë, sepse kishte nevojë të "ulte homoseksualitetin e tij" dhe të vepronte më shumë si një burrë.

Burrave u mohohet e drejta e qëndrimit në shtëpi për të qenë pranë fëmijës së porsalindur.


Një formë tjetër e diskriminimit gjinor mashkullor ndodh kur burrave u refuzohet leja familjare në dispozicion të grave pas lindjes ose birësimit të një fëmije të ri. Në *EEOC v Estee Lauder Companies, Inc.*, EEOC paditi sepse kompania e kozmetikes nuk u dha burrave akses në të njëjtat përfitime të lejes prindërore që kanë në dispozicion gratë.



Diskriminimi i burrave në gjykata dhe instanca të tjera shtetërore [7] [8]

Diskriminimi me bazë gjinore, është në fakt një nga temat më të diskutuara të viteve të fundit, në Shqipëri e kudo në botë. Megjithatë, këto diskutime kanë qenë gjithnjë të njëanshme. Teksa kemi dëgjuar shumë të flitet për diskriminimin e grave, apo për lëvizjet feministe të iniciuara nga ky diskriminim, rrallë, madje mund të thuhet edhe kurrë, nuk është diskutuar për anën tjetër të medaljes – diskriminimin e burrave.

Ndonëse mund të duket e pabesueshme, edhe ata diskriminohen: në familje, shoqëri, punë e institucione arsimore. Sidoqoftë, diskriminimi më i rrezikshëm dhe i padrejtë ndaj burrave, iu bëhet pikërisht në gjykata e instanca shtetërore



Gjyqtarët mund të jenë po aq të njëanshëm, ndonjëherë edhe më shumë, sesa publiku i gjerë, në marrjen e vendimeve për çështjet gjyqësore ku sfidohen rolet tradicionale gjinore. Shumë prej tyre, nuk janë në gjendje të faktorizojnë kështu bindjet e tyre personale, apo përvojën me çështje të ngjashme, teksa janë në shqyrtim të një çështjeje gjyqësore.

Studiues dhe psikologë të 'Social Psychological and Personality Science' e vërtetuan më së miri fenomenin e diskriminimit të burrave në gjykata, kur në një eksperiment social, iu dhanë 500 gjykatësve (68% meshkuj, 32% femra), një çështje gjyqësore të stisur mbi kujdestarinë e fëmijës së dy prindërve të divorcuar.



Në dosjen që iu paraqit gjyqtarëve, si nëna, ashtu edhe babai i fëmijës, ishin njëlloj të arsimuar dhe kualifikuar, të dy të punësuar me kohë të plotë, dhe në gjendje ekonomike të mirë. Sidoqoftë, rezultatet e eksperimentit, që ishin sa të pritshme, aq edhe shokuese, nuk e reflektuan aspak këtë: 97% e gjyqtarëve i dhanë më shumë kohë kujdestarie nënës, ndërkohë që vetëm 3% e kampionit, i dhanë kohë të barabartë kujdestarie të dy prindërve, apo i dhanë më shumë kohë babait.



Të tjera hulumtime, nxjerrin në pah, se të tilla vendime te pabaza, nuk merren vetëm në rastet e kujdestarive të fëmijëve të dy ish bashkëshortëve të divorcuar, por në pothuajse çdo çështje gjyqësore, ndërsa gjykata nuk është i vetmi vend i ligjit dhe të së drejtës, ku burrat diskriminohen. Në pothuajse çdo instancë shtetërore, (Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor, Sigurimet Shëndetësore, Drejtoria e Tatimeve, Drejtoria e Hipotekës, Ambasada, etj), merren çdo ditë vendime të bazuara në asgjë më tepër sesa stereotipe shoqërore.



Sa më herët të braktisen këto stereotipe, dhe të përqafohet barazia e plotë gjinore mes burrave dhe grave, si dy qenie me të drejta, detyra, aftësi dhe mundësi të barabarta, aq më shpejt do t'i jepet fund maskaradës së trajtimeve të padrejta në dyert e shtetit, në kurriz të burrave, për fajin e vetëm se kanë lindur meshkuj, apo anasjelltas; dhe aq më e shëndetshme do të jetë shoqëria në të cilën jetojmë.

SHTOJCË: Nëse mendoni se jeni trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe keni rënë pre e diskriminimit nga gjykatat apo nga instancat e tjera shtetërore, mos nguroni për asnjë moment të bëni denoncimin tuaj në KMD (Komisioneri për Mbrojtjen ndaj Diskriminimit), në numrin e telefonit pa pagesë 08000606 ose në email-in e institucionit, info@kmd.al.

Pasojat e diskriminimit tek burrat [9] [10]

Burrat përpiqen vazhdimisht t'i përshtaten një modeli burrëror të të qenit të fortë, të ashpër dhe stoikë. Ata kushtëzohen, që në moshë shumë të re, të mos shprehin emocione, sepse të shprehësh emocione do të thotë të jesh "i dobët". Megjithatë shtyrja e tyre që në fëmijëri drejt këtij modeli burrëror perfekt dhe të fortë nuk jep gjithmonë rezultatet më të mira.

Ka tendencë të ketë më shumë përdorim të substancave dhe përdorim të alkoolit tek burrat, gjë që thjesht mund të pasqyrojë shqetësimin që ata po ndjejnë. Në vend që të flasin për probelemet e tyre, për burrat është më e lehtë të pijnë për to. Në të vërtetë, ata kanë gati dy herë më shumë gjasa se gratë për të patur varësi nga alkooli.



Por, pirja mund të thellojë depresionin dhe të rrisë sjelljet impulsive, ndaj dhe mund të kenë grindje të ndryshme, aksidente rrugore apo tendenca të ndryshme dhune nën efektin e alkoolit apo substancave të tjera, të cilat i shikojnë si rrugën e vetme të shpëtimit nga problemet.

Vetëvrasja shpesh mendohet si një çështje neutrale gjinore, por në të vërtetë, është një problem që prek burrat shumë më tepër sesa gratë. Diferenca midis numrit të vetëvrasjeve tek burrat është 3 deri në 4 herë më e madhe se te gratë. Gratë, në të vërtetë kanë më shumë gjasa të përpiqen të vrasin veten - tre deri në katër herë më shumë të ngjarë. Por burrat kanë më shumë probabilitet të vdesin prej saj. Burrat që i përmbahen më fort idealeve burrërore e shohin marrjen e ndihmës psikologjike negativisht. Kjo mund të rezultojë në grumbullimin e ndjenjave pa një valvul shpëtimi dhe mund të përshkallëzohet në një pikë krize. Nëse një djalë thotë se kuptimi i tij për të qenë burrë do të thotë që nuk mund të zbulojë ndonjë dobësi, sepse kjo do ta bënte më pak burrëror, atëherë nëse ai fillon të vuajë nga depresioni e vetmja gjë që i shkon në mendje është që duhet ta mbajë atë për vete.

Kjo është veçanërisht e vërtetë kur sjellim në mendje se simptomat e burrave të depresionuar janë të ndryshme nga ato të grave. Në vend që të qajnë më shumë, ata kanë rritje të zemërimit, marrje të rrezikut, nervozizëm dhe fillojnë abuzimin e substancave. Për burrat është më e lehtë të flasin për pagjumësinë, për dhimbjen e shpinës, se sa të thonë se po ndihen të trishtuar dhe të paaftë.

Burrrat mund të rriten me një frymë diskriminuese. Nuk është e veshtirë të kuptohet që shumica e burrave detyrohen të jenë homofobikë apo diskriminues ndaj grave apo grupeve të tjera shoqërore. Ata shfaqin tendenca bullizuese dhe bëjnë abuzim verbal deri në fizik kundrejt individëve që i konsiderojnë të dobët.

Në rreshtat më poshtë paraqiten disa deklarata për ndjesitë që disa djem kanë përjetuar nën presionin e vazhdueshëm të shoqërisë për të qenë burrëror:

“Kam ndjerë gjithmonë presionin për të provuar se isha burrëror - kjo kryesisht konsistonte në të qenit nënçmues ndaj burrave homoseksualë, pasi ishte gjëja më e keqe në botë. Askush nga ne në të vërtetë nuk njihnte ndonjë homoseksual, kështu që u përdor mes nesh për të dëbuar çdo sjellje jo-mashkullore. Nëse dikush shfaqte ndonjë shenjë ndjeshmërie, kujdesi ose dhembshurie ata shpejt etiketoheshin si ‘i dobët’ dhe bëheshin objekt talljeje dhe përjashtoheshin nga grupi. Unë gjithashtu ndjeva presionin për të mos u hapur, për të mbajtur ndjenjat e mia për veten time, për të qenë stoik, logjik dhe pa ndjenja. Ky presion ishte më shumë si një kod i pashkruar i sjelljes që nuk guxon ta kalosh. Djemtë nuk qajnë - kështu që nëse duhet të qani, qani vetëm dhe mos e tregoni që e keni bërë.”

“Në jetën time ndjeva peshën e pritjes për të qenë djali, babai ose bashkëshorti i përsosur. Problemi është se burrat i shohin kontributet e tyre dhe pritshmëritë ndaj tyre si presion nga ndikimet e jashtme, në veçanti pritjet shoqërore të shfaqura në media ose të komunikuara në punë, familje dhe në marrëdhënie. Një burrë që nuk arrin të pranojë se kush është dhe i nënshtrohet presionit për t'u bërë ajo që shoqëria dëshiron që ai të bëhet, ka mlllef dhe zemërohet kur i thonë se çfarë të bëjë. Realiteti është se disa burra i shohin përgjegjësitë e tyre si presion, në vend që t'i shohin ato si një mundësi për të bërë arritje më të mëdha.”

“Kishte gjithnjë një betejë të vazhdueshme mes asaj që unë isha dhe asaj që tregoja në shoqëri. Doja të ndihesha i pranuar, ndaj nuk shfaqja gjithnjë anën time të vërtetë, por atë që shoqëria priste prej meje, ndaj filova të ndihesha i izoluar dhe më i trishtuar. Tentova të vetëvritesha, por fatmirësisht arrita ta pranoja veten time dhe të shfaqja atë që unë isha.”



Çfarë mund të bëjmë ne?

Shumë burra hezitojnë ta pranojnë që kanë rënë pre e diskriminimit. Ata mendojnë se një ankesë e tyre mund t'i bëjë të duken më pak burrërorë ose mund t'ju ulë autoritetin. Por burrat kanë të njëjtën të drejtë, ashtu si dhe gratë, të reagojnë dhe të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji.

Shumë prej tyre hezitojnë ta pranojnë që kanë rënë pre e diskriminimit. Ata mendojnë se një ankesë e tyre mund t'i bëjë të duken më pak burrërorë ose mund t'ju ulë autoritetin. Por burrat kanë të njëjtën të drejtë, ashtu si dhe gratë, të reagojnë dhe të jenë të mbrojtur nga diskriminimi i çdo lloji. Në qoftëse keni qenë viktimë e diskriminimit, gjëja e parë që duhet të bëni është të kundërshtoni. Ju në mënyrë të sjellshme mund t'i thoni personit përballë që të ndalojë së ofenduari ose bullizuari.



Në shtete të caktuara jepet e drejta që t'i paraqitet një letër ankese departamentit të burimeve njerëzore duke parashtruar problemin tuaj. Hapat që ju mund të ndërmerreni varen nga madhësia e diskriminimit, nëse ju i përkisni ndonjë sindikate, ose dhe nga natyra e diskriminimit.

Ne si shoqëri duhet të ndërgjegjësohemi në lidhje me mënyrën se si i shprehim mendimet dhe idetë tona. Duhet të kuptojmë se jo të gjithë jemi të njëjtë dhe jo të gjithë kemi të njëjtat qëllime dhe parime në jetë. Mënyra e të menduarit dhe arsyetuarit na diferencon nga njëritjetri, por kjo s'do të thotë që jemi të lirë të gjujkojmë të tjerët për mënyrën se si ata mendojnë ose arsyetojnë në lidhje me një çështje të caktuar. Secili nga ne ka rënë pre e diskriminimit të paktën një herë në jetën e tij dhe kjo duhet të na bëjë që të mendojmë dy herë dhe të flasim një herë.

Ligjet të cilat mbrojnë palët nga diskriminimi duhet të jenë të qarta dhe rigorozisht të prera. Ashtu siç ka ligje që dënojnë diskriminimin kundrejt pjestarëve të caktuar të shoqërisë ashtu duhet të ketë edhe ligje që mbrojnë meshkujt dhe jo vetëm.



Referenca

- [1] "What drives discrimination and how do we stop it?". www.amnesty.org. Amnesty International. Retrieved October 13, 2020. Discrimination occurs when a person is unable to enjoy his or her human rights or other legal rights on an equal basis with others because of an unjustified distinction made in policy, law or treatment.
- [2] ^ Jump up to:a b "Discrimination: What it is, and how to cope". American Psychological Association. October 31, 2019. Retrieved October 13, 2020. Discrimination is the unfair or prejudicial treatment of people and groups based on characteristics such as race, gender, age or sexual orientation.
- [3] ^ "discrimination, definition". Cambridge Dictionaries Online. Cambridge University. Retrieved March 29, 2013.
- [4] ^ Introduction to sociology. 7th ed. New York: W. W. Norton & Company Inc, 2009. p. 334.
- [5] <https://www.un.org/esa/socdev/family/docs/men-in-families.pdf>
- [6] <https://www.eandblaw.com/uncategorized/2019/02/04/what-does-male-gender-discrimination-look-like/>
- [7] <https://www.sciencedaily.com/releases/2018/04/180403085049.htm#:~:text=Summary%3A,according%20to%20a%20new%20study>
- [8] <https://www.ojp.gov/pdffiles1/Digitization/127983NCJRS.pdf>
- [9] <https://www.bbc.com/future/article/20190313-why-more-men-kill-themselves-than-women>
- [10] <https://www.unimedliving.com/men/men-share-on/the-pressures-society-puts-on-men.html>